




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 14.12.2020



Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 09.12.2020, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1127, të datës 17.11.2020, paraqitur nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (r), nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (m), nenin 27, shkronja (c), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, nenin 7, nenin 13, të 'Rregullores për përmbajtjen e simboleve komunale, procedurën, mënyrën dhe kushtet për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe shpërblimeve tjera', Nr. 83, të datës 06.06.2016 mori:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit vlerësues për zgjedhjen e Krijuesit të vitit 2020

1. Për formimin e Komisionit vlerësues për zgjedhjen e 'Krijuesit të vitit 2020', në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve:
 - 1.1 Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, anëtare;
 - 1.2 Eglantina Azemi - Anëtare e Kuvendit të Komunës, anëtare;
 - 1.3 Aida Alimi - Anëtare e Kuvendit të Komunës, anëtare;
 - 1.4 Ali Ismaili - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtar;
 - 1.5 Ali Topalli - Zyrtar për Informim, anëtar;
 - 1.6 Elmije Grajçevci-Zymberi - Shefe në Drejtorinë e Arsimit, anëtare;
 - 1.7 Valmir Sadiku - Shoqëria Civile, anëtar.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit vlerësues, nga pika një e vendimit, është të shqyrtojë dhe vlerësojë kandidatët më të sukseshëm në konkursin për 'Krijuesin e vitit 2020'.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Komisionit, Drejtorisë së KRS dhe Arkivit.



Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 14.12.2020

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 09.12.2020, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1127, të datës 17.11.2020, paraqitur nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (r), nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (m), nenin 27, shkronja (c), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, nenin 8, nenin 13, të 'Rregullores për përmbajtjen e simboleve komunale, procedurën, mënyrën dhe kushtet për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe shpërblimeve tjera', Nr. 83, të datës 06.06.2016 mori:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit vlerësues për zgjedhjen e Sportistëve të vitit 2020

1. Për formimin e Komisionit vlerësues për zgjedhjen e 'Sportistëve të vitit 2020', në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve:
 - 1.1 Sabri Rexhepi - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtar;
 - 1.2 Doruntina Jashari - Anëtare e Kuvendit të Komunës, anëtare;
 - 1.3 Arjana Zogjani - Anëtare e Kuvendit të Komunës, anëtare;
 - 1.4 Migjen Kolshi - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtar;
 - 1.5 Fatlum Berisha - Zyrtar për Rini dhe Sport, anëtar;
 - 1.6 Ejup Qyqalla - Shef për Shërbime Publike, anëtar;
 - 1.7 Maliq Thaçi - Shoqëria Civile, anëtar.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit vlerësues, nga pika një e vendimit, është të shqyrtojë dhe vlerësojë kandidatët më të sukseshëm në konkursin për 'Sportistët e vitit 2020'.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Komisionit, Drejtorisë së KRS dhe Arkivit.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës


Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 16.12.2020

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 09.12.2020, pas shqyrtimit të parë të Projekt-Rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijëve në Komunën e Fushë-Kosovës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (c, d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 8 të udhëzimit administrativ Nr. 01/2015, për transparencë në komuna, nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c, ç), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim për diskutim publik të Projekt-Rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijëve në Komunën e Fushë-Kosovës

1. Për aprovimin në parim për diskutim publik të, 'Projekt-Rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijëve në Komunën e Fushë-Kosovës.
2. Drejtoritë përgjegjëse të komunës dhe Njësitit për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore, do të ofrojnë informata të nevojshme për opinionin - qytetarët e interesuar përmes kontakteve me grupet e interesit dhe palët e interesuara për t'i caktuar propozimet, për ndryshime në projekt-rregullore.
3. Diskutimi publik për 'Projekt-Rregulloren për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijëve në Komunën e Fushë-Kosovës', do të zgjatë katërmëdhjetë ditë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe drejtoritë përgjegjëse.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorive të Komunës, Njësitit për Barazi Gjinore dhe Arkivit.


Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 16.12.2020

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 09.12.2020, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 472, të datës 04.12.2020, paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, nenin 14, të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 22, paragrafi 1, nenin 23, të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110, (Gazeta Zyrtare Nr. 18/2012), nenin 4, nenin 5, nenin 10, nenin 11, nenin 12, të Udhëzimit Administrativ për taksat administrative për leje ndërtimore, leje rrënim dhe tarifave për rregullimin e infrastrukturës Nr. 02/2018, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (ç, nj), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), nenin 54, shkronja (dh, f) të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:


V E N D I M

Për aprovimin në parim për diskutim publik të Propozimit Nr. 472, të datës 04.12.2020, për caktimin e taksës administrative për leje të ndërtimit, leje të rrënit dhe tarifës rregullative për rritjen e densitetit në Infrastrukturë për vitin 2021

1. Për aprovimin në parim për diskutim publik të Propozimit Nr. 472, të datës 04.12.2020 për caktimin e taksës administrative për leje të ndërtimit, leje të rrënit dhe tarifës rregullative për rritjen e densitetit në Infrastrukturë në vitin 2021 si vijon:
 - 1.1 Taksa administrative për lëshimin e lejeve ndërtimore në shumë prej 1.55€ për një metër katror në kategorinë e parë;
 - 1.2 Taksa administrative për lëshimin e lejeve ndërtimore në shumë prej 2.10€ për një metër katror në kategorinë e dytë;
 - 1.3 Taksa administrative për leje të rrënit në shumë prej 0.95€ për një metër katror;
 - 1.4 Tarifa rregullative për rritjen e densitetit në infrastrukturë në shumë prej 4.84€ për një metër katror.
2. Miratimi i taksave administrative dhe tarifës për rregullimin e densitetit në infrastrukturë për vitin 2021, mbështetet në shkresën e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit Nr. 4639-2/20, të datës 24.11.2019.
3. Objektet publike institucionale që financohen nga institucionet shtetërore lirohen nga taksat për leje ndërtimore.
4. Llogaritja e taksave administrative për leje ndërtimore të kategorisë së parë dhe të kategorisë së dytë, leje të rrënit dhe tarifa për rregullimin e densitetit në infrastrukturë, bëhet duke u mbështetur në pikën një të vendimit.
5. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, për zbatimin e vendimit, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Planifikimit Urban.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PU dhe Arkivës.

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha**





**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



Stamp of the Municipality of Kosovo-Polje, Directorate of Administration. It includes the number 179 and the date 29.12.2020.

Datë: 28.12.2020

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 24.12.2020, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 169, të datës 14.12.2020, paraqitur nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 40, shkronja (d), nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (dh), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, nenin 9, paragrafi 3, të 'Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës', Nr. 62, të datës 16.05.2013 mori:

V E N D I M


Për formimin e Grupit Punues për Hartimin e Planit Vjetor të Punës së Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës për vitin 2021

1. Për formimin e 'Grupit Punues për Hartimin e Planit Vjetor të Punës së Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës për vitin 2021' në përbërje prej trembëdhjetë (13) anëtarëve:
 - 1.1 Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, kryesuese e grupit;
 - 1.2 Fadil Krasniqi - Nënkyetar i Komunës, anëtar;
 - 1.3 Hasan Gjyrevci - Zyrtar Ligjor për Kuvend dhe Komitete, anëtar
 - 1.4 Remzi Shala - Përfaqësues i Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtar;
 - 1.5 Durim Hajra - Përfaqësues i Lëvizjes Vetëvendosje, anëtar;
 - 1.6 Aida Alimi - Përfaqësues i Partisë Demokratike të Kosovës, anëtare;
 - 1.7 Mehdi Lahu - Përfaqësues i Partisë Socialdemokrate, anëtar;
 - 1.8 Ali Ismaili - Përfaqësues i Partisë së Drejtësisë, anëtar;
 - 1.9 Driton Hasolli - Përfaqësues i Aleancës Kosova e Re, anëtar;
 - 1.10 Mensur Grajçevci - Përfaqësues i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, anëtar;
 - 1.11 Migjen Kolshi - Përfaqësues i Iniciativës Qytetare të Fushë-Kosovës, anëtar;
 - 1.12 Hysni Hasani - Përfaqësues i Partisë Demokratike të Ashkalinjëve të Kosovës, anëtar;
 - 1.13 Suhat Ademi - Zëvendës Kryesues i Kuvendit të Komunës për Komunitete, anëtar.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Grupit Punues është hartimi i Planit Vjetor të Punës së Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës për vitin 2021.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Grupit Punues dhe Arkivit.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 28.12.2020

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 24.12.2020, pas shqyrtimit të Rekomandimit nga Komitetit për Politikë dhe Financa Nr. 177, të datës 24.12.2020, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (ç), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori: -

V E N D I M

Për ndihmë financiare për qytetarët e infektuar me Coronavirusin Covid - 19

1. Për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 100.00€, ndihmë për çdo qytetarë të prekur me sëmundjen infektive të pandemisë së Coronavirusit Covid - 19 me testimin RT-PCR, nga buxheti i komunës sipas programeve nëpër Drejtoritë e Komunës në përputhje me kriteret e cekura në vijim:
 - 1.1 Të gjithë qytetarët me vendbanim të përhershëm në Komunën e Fushë-Kosovës, që rezultojnë të prekur pozitiv me virusin Covid - 19, në listat zyrtare të raporteve ditore të Institutit Kombëtarë të Shëndetit Publik të Kosovës me testimin RT-PCR;
 - 1.2 Të gjitha familjet me vendbanim të përhershëm në Komunën e Fushë-Kosovës, anëtarët e të cilëve e kanë humbur jetën si pasojë e infektimit me virusin Covid - 19, e të cilët kanë qenë në listat zyrtare të raporteve ditore të Institutit Kombëtarë të Shëndetit Publik të Kosovës me testimin RT-PCR.
2. Ky vendim vlen së zbatuari prej fillimit të pandemisë në muajin mars 2020 deri në përfundimin e pandemisë.
3. Sigurimi i mjeteve financiare për zbatimin e këtij vendimi në përputhje me mundësitë buxhetore, nga të hyrat vetjake të bartura të vitit 2020, në vitin 2021, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë së Shëndetësisë e Mirëqenies Sociale.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së SHMS, Drejtorive tjera të Komunës dhe Arkivit.


Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



Datë: 03.02.2021

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.01.2021, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 36, të datës 18.01.2021, paraqitur nga Kryetari i Komunës dhe i shqyrtuar në mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (a), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (a), nenin 27, shkronja (ç) të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, nenin 11, të Rregullores për ndarjen e subvencioneve Nr. 83, të datës 14.06.2013, mori:

V E N D I M

Për lejimin e shpenzimeve të mjeteve financiare nga kodi i participimit për subvencione në bujqësi për vitin 2021

1. Lejohet shpenzimi i mjeteve financiare në shumë prej 273,000.00€, prej 'Kodit të participimit, subvencioneve dhe transfereve duke e përfshirë edhe mbetjen e mjeteve financiare në shumën prej 72,185.12€, nga participimi i fermerëve në vitin 2020, për realizimin e projekteve për zhvillimin e bujqësisë në vitin 2021 si vijon:
 - 1.1 Mjetet financiare, në shumë prej 45,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Serrave';
 - 1.2 Mjetet financiare, në shumë prej 60,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Motokultivatorëve';
 - 1.3 Mjetet financiare, në shumë prej 5,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Ciklonëve - Shpërndarësve të plehut';
 - 1.4 Mjetet financiare, në shumë prej 100,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Mekanizmit bujqësor';
 - 1.5 Mjetet financiare, në shumë prej 10,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Pajisjeve bletare';
 - 1.6 Mjetet financiare, në shumë prej 8,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Mullinjëve';
 - 1.7 Mjetet financiare, në shumë prej 15,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Spërkatësve për traktorë';
 - 1.8 Mjetet financiare, në shumë prej 20,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Folive';
 - 1.9 Mjetet financiare, në shumë prej 10,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për


realizimin e projektit për blerjen e 'Plehut Azotikë';

2. Në realizimin e projekteve për zhvillimin e bujqësisë nga paragrafi 1, nënparagrafët prej 1.1 e deri tek nënparagrafin 1.7, të paragrafit një të vendimit, participojnë edhe fermerët e Komunës së Fushë-Kosovës në vitin 2021, me 20% të vlerës së projekteve.
3. Sigurimi i mjeteve financiare nga buxheti i Komunës sipas pikës një (1) të vendimit dhe kryerja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është kompetencë e Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit, Drejtorisë së Bujqësisë e Zhvillimit Rural dhe Zyrës së Prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Zyrës së Prokurimit, Drejtorisë së BZHR dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës


Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 03.02.2021

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.01.2021, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 44, të datës 20.01.2021, paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, të shqyrtuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 17, shkronja (a), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a, g, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 10, paragrafi 10.2, të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (a), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b, f, nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit Nr. 44, të datës 20.01.2021 për lirimin nga taksat komunale për ushtrimin e aktiviteteve biznesore të subjekteve afariste në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitin kalendarik 2021

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 44, të datës 20.01.2021 për lirimin e bizneseve nga pagesa e taksës komunale për vitin 2021 për të gjitha subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike dhe biznesore në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, në funksion të krijimit të lehtësimeve për bizneset ekzistuese dhe avantazhe për hapjen e bizneseve të reja dhe gjenerim të punësimit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Zhvillim Ekonomik.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë për ZHE dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU	
Nr.faq/Br.ste.		10
Data/Datum.		04.02.2021
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE		

Datë: 03.02.2021

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.01.2021, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 45, të datës 20.01.2021, paraqitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, të shqyrtuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 17, shkronja (m), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (i), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (d), nenin 27, shkronja (ç), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, nenin 41, paragrafi (3), të Rregullores për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës Komunale nr. 125, të datës 25.09.2014, mori:

V E N D I M


Për lejimin e mjeteve financiare për punëtorët shëndetësorë për vitin 2021

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 45, të datës 20.01.2021, për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 60,000.00€, për punëtorët shëndetësorë të punësuar në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovës, përmes projektit të Caritas Kosova për vitin 2021.
2. Mjetet financiare të lejuara në pikën një të këtij vendimit shpenzohen, për nivelizimin - harmonizimin e përafërt të pagave në kohën e pandemisë së Coronavirusit Covid -19, në shuma si vijon: për mjekët 150.00€, për infermierët 100.00€ dhe për stafin mbështetës 50.00€.
3. Kryerja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe sigurimi i mjeteve financiare nga buxheti i Komunës sipas pikës një dhe dy të vendimit, është në kompetencë e Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit, Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në bashkërendim në mes të Komunës së Fushë-Kosovës dhe Caritas Kosova.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë për FB, Drejtorisë për SHMS, Caritas Kosova dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës



Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 03.02.2021

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.01.2021, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 40, të datës 20.01.2021, paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, mbështetur në kërkesën e përfaqësuesit të Këshillit të Bashkësisë Islame në Fushë-Kosovë me Nr. 1201, të datës 01.12.2020 dhe kërkesën e përfaqësuesit të Kishës Ortodokse Serbe në Fushë-Kosovë me Nr. 39, të datës 19.01.2021, të shqyrtuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2021

1. Për vazhdimin e mbulimit të shpenzimeve të varrimit për banorët e Komunës së Fushë-Kosovës me dokumentacion personal të identifikimit, për vitin 2021 në shumë të mjeteve financiare prej 195.00€, nga buxheti i komunës për çdo ceremoni të varrimit, përfshirë të gjitha komunitetet fetare.
2. Sigurimi i mjeteve financiare sipas pikës një të vendimit nga buxheti i komunës, për vitin 2021, është në kompetencë të Drejtorisë së Financave e Buxhetit.
3. Kryerja e procedurave tjera për zbatimin e vendimit është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit.
4. Për shpenzimin e mjeteve financiare të lejuara, përfaqësuesit e Këshillit të Bashkësisë Islame të Fushë-Kosovës, Kishës Ortodokse dhe bashkësive tjera fetare i raportojnë me shkrim Kuvendit të Komunës.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së SHPM, Këshillit të Bashkësisë Islame në Fushë-Kosovë, Kishës Ortodokse Serbe në Fushë-Kosovë dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha

